



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Ekstraktet e Procesverbaleve dhe Transkripteve nga mbledhjet: 112 dhe 113 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ të vitit 2023 t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/121

Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Verërat.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohen, anëtarët e Këshillit drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në këtë përbërje:
 - 1.1. Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit:
 - 1.1.1. Valbona Fetiu - Mjeku;
 - 1.1.2. Muhamer Ibriqi.
 - 1.2. Përfaqësues i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve:
 - 1.2.1. Ferdeze Agaj - Mehmeti;
 - 1.2.2. Leunora Zylfijaj - Ahmeti.
 - 1.3. Përfaqësues i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:
 - 1.3.1. Valmira Sejdiu.
 - 1.4. Përfaqësues i ministrive tjera relevante:
 - 1.4.1. Albana Sahiti - Morina- Ministria e Shëndetësisë.
 - 1.5. Përfaqësues të universiteteve:
 - 1.5.1. Ramadan Duraku - Universiteti "Hasan Prishtina"- Prishtinë;
 - 1.5.2. Driton Sylqa - Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë.
 - 1.6. Përfaqësues të organizatave të partnerëve social:
 - 1.6.1. Besim Mustafa - Oda Ekonomike e Kosovës;
 - 1.6.2. Bedri Xhafa - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare.
 - 1.7. Përfaqësues të OJQ-ve për arsim dhe aftësim:
 - 1.7.1. Afrim Gjellaj - KIMERK/MIRECK.
 - 1.8. Përfaqësues të ofruesve të arsimit dhe aftësimin nga sektori privat:
 - 1.8.1. Driton Hapçiu - Cactus Education.
 - 1.9. Përfaqësues për nxënësit me nevoja të veçanta:
 - 1.9.1. Rustem Gashi - Handikos.

2. Anëtarët e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi emërohen me mandat prej 4 vitesh.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, nenit 5 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/134 të datës 01.03.2017, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për bartje të së drejtës së shfrytëzimit, përkatësisht ndryshimit të shfrytëzuesit në ngastrat kadastrale sipas Shtojcës 1. të këtij Vendimi, në dobi të interesit publik për periudhën tridhjetë (30) vjeçare.
2. Përfitues i të drejtës së shfrytëzimit të ngastrave, me të dhënat e detajuara dhe të paraqitura në Shtojcën 1. të këtij Vendimi, është Ministria e Ekonomisë.
3. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit, sipas nenit 1. të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të dhënies me qera për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në burime të ripërtërishme të energjisë, përmes përzgjedhjes së investitorëve nga Ministria e Ekonomisë me procedurë të hapur konkurruese-ankand, e bazuar në kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.
4. Ngastrat me të dhënat e paraqitura në Shtojcën 1. të këtij Vendimi regjistrojnë si shfrytëzues Ministrinë përgjegjëse për Energji.
5. Ky Vendim nuk paragjykon zbatimin e kontratave ekzistuese deri në skadimin e tyre mbi këto parcela të nënshkruara nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës, implementimi i të cilave ka filluar para miratimit të këtij Vendimi.
6. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Komuna e Rahovecit

Nr.	Parcela nr.	Zona Kadastrale	Komuna	Pronari	Sipërfaqja
1	500-1	Kramovik	Rahovec	OP SHARRI -PRISHTINË;EKONOMIA E PYJEVE-RAHOVEC	952267
2	597-1	Kramovik	Rahovec	OP SHARRI -PRISHTINË;EKONOMIA E PYJEVE-RAHOVEC	976151

Komuna e Rahovecit

Nr.	Parcela nr.	Zona Kadastrale	Komuna	Pronari	Sipërfaqja
1	184-0	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	90323
2	186-0	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	165579
3	187-0	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	15435
4	842-0	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	270723
5	843-0	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	568002
6	199-1	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	607787
7	199-2	Petkovicq	Rahovec	PASURI SHTET.E KOSOV.K.K.RAHOVEC SHFRY.EKON.PYE.RAHOVEC	2000



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit "Ndërtimi i Parkut Fotovoltaik" për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh. A.), Zona Kadastrale Kryshevc, Komuna Obiliq dhe Zona Kadastrale Fushë Kosovë, Komuna Fushë Kosovë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh. A.)
5. Kompensimi i pronave të pronarëve që shpronësohen, shpenzimet e procedurës së shpronësimit, vlerësimit dhe të gjitha obligimet tjera që mund të rrjedhin nga proceset administrative dhe gjyqësore do të bëhen nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh. A.) dhe buxheti i saj.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Departamentit për kontrollin e Tregut të Mallrave Strategjike, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 11/68 i datës 23.03.2022 për formimin e Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike.
2. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2. e Vendimit të lartcekur në paragrafin 1. të Vendimit bazë, ashtu që Major Muhamet Thaqi /MM anëtar, zëvendësohet me Nënkolonel Fidaim Elshani anëtar.
3. Ndryshohet dhe plotësohet pika 3. e Vendimit të lartcekur në paragrafin 1. të Vendimit bazë, ashtu që Shkëlzen Morina/MPJD anëtar, zëvendësohet me znj. Elmaze Pireva/MPJD anëtare.
4. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 21 paragrafi 1, nën-paragrafit 1.1 dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/104, të datës 10.08.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/26, të datës 23.04.2020, me Vendimin Nr. 11/28, të datës 28.08.2020, me Vendimin Nr. 02/12, të datës 21.05.2021

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1 e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/104, të datës 10.08.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 11/28, të datës 28.08.2020 si në vijim:

1.1 "Zenel Leku – Kryetar i Komisionit".

2. Mandati i kryetarit të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit sipas pikës 1. të këtij Vendimi është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat shtesë.
3. Kryetari i Komisionit nga pika 1. e këtij Vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij, t'i kryej në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me Vendimin Nr. 472/2022, dt. 14.12.2022, ka propozuar z. Zenel Leku, Gjyqtar në Gjykatën Supreme, për Kryetar të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Ky propozim rrjedh nga neni 21 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2) i Ligjit Nr. 08/L-109 për kompensimin e viktimave të krimit, për faktin se ish-kryesuesja e këtij Komisioni znj. Nesrin Lushta, ka arritur moshën e pensionimit dhe rrjedhimisht i është pushuar mandati sipas fuqisë ligjore.

Andaj, duke pas për bazë të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Akademinë e Drejtësisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negociimin e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike për Projektin "Qëndrueshmëria Klimatike në Sektorin e Ujit në Kosovë".
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/121

Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për negocimin e Amendamentit të "Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit" ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelat 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare nga viti paraprak për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe ministritë e ndikuara, për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me Tabelat nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës për informim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Pasqyra Preliminare Financiare për Ekzekutimin e Buxhetit dhe Bilancin e Fondeve për vitin 2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Pasqyrën Preliminare nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.07/L-030 për Ratifikimin e Marrëveshjes Kornizë për Kredi ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës – Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19, të Ligjit Nr.08/L-009 për Ratifikimin e Amendamentit Nr.1 të Marrëveshjes Kornizë së Kredisë së datës 14 gusht 2020, të Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.12/31 të datës 25 gusht 2021 dhe me Vendimin Nr.01/49 të datës 17 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.15/62 të datës 23 shkurt 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pagesa e shtesës neto prej 10% e pagës bazë, por jo me pak se 60 € (gjashtëdhjetë euro), për punonjësit shëndetësor të sektorit publik (profesionistët shëndetësor dhe stafin mbështetës), për muajin janar 2023, në shumë totale deri në 1,000,000.00 € (një milionë euro) në zbatim të masës 4.1 – Mbështetja e Shëndetësisë, bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, transferohen, buxhetohen dhe alokohen në Kodin 00098, në kategorinë “paga dhe shtesa” në secilën organizatë buxhetore të ndikuar nga ky Vendim, bazuar në listën finale të ekzekutuar, dhe realizohet jo më vonë se 15 ditë nga ekzekutimi i pagave.
3. Shtesa sipas paragrafit 1. kalkulohet mbi pagën bazë, sipas afatit në paragrafin 1, në bazë të listave emërore që pranohen nga Ministria e Shëndetësisë për të gjitha organizatat buxhetore që kanë punonjës shëndetësor, bazuar në pagën bazë të definuar në Sistemin e Pagave të Thesarit të Kosovës.
4. Listat finale të aprovuara dhe dërguara nga Ministria e Shëndetësisë për realizim nga Thesari i Kosovës sipas paragrafit 3. të këtij Vendimi, paguhet përmes Sistemit të Pagave, me pagën e muajit përkatës, përkatësisht vijues.

5. Mjetet e shpenzuara sipas këtij Vendimi janë subjekt i rimbursimit eventual, deri në shumën në dispozicion të mjeteve të lira të passhpenzuara nga kredia Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës, si financim retroaktiv nëpër organizata buxhetore aty ku ka ndodhur shpenzimi, bazuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Shëndetësisë, Organizatat Buxhetore dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 31/99 të datës 30 shtator 2022, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr.10/102 të datës 26 tetor 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M


1. Ndryshohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 31/99 i datës 30.09.2022, i plotësuar dhe ndryshuar, ashtu që pika 5. e paragrafit 1. riformulohet si në vijim:

“1.5 Në kuadër të masës 3.6 – Mbështetja e likuiditetit familjar, të gjithë punonjësit e sektorit publik të cilët kanë punuar me orar të plotë gjatë tërë muajit dhe që marrin pagë bazë primare deri në 1,000 € (njëmijë) e që kualifikohen për përfitim, mbështeten me shtesën prej 50 € (pesëdhjetë euro) nga muaji shtator 2022 deri në muajin janar 2023.

2. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 3,800,000 € (tre milionë e tetëqind mijë euro), për zbatimin e pikës 1.5 të Vendimit Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, i plotësuar dhe ndryshuar, në kuadër të Masës 3.6 – Mbështetja e likuiditetit familjar të Pakos për Ringjallje Ekonomike.
3. Mjetet e ndara sipas pikës 2. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, dhe transferohen në nën-programin “Thesari” me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.
4. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, për ekzekutimin e subvencionit tek përfituesit e përzgjedhur sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me vendim të veçantë të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, sipas autorizimit të dhënë me pikën 3. të Vendimit Nr. 31/99 të datës 30.09.2022, i plotësuar dhe ndryshuar.

5. Paragrafët tjerë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.31/99 të datës 30.09.2022, i plotësuar dhe ndryshuar, mbesin të pandryshuar.
6. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/121
Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 25, paragrafi 1.2. të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:


V E N D I M

Për Masat Emergjente në Furnizimin e Energjisë

1. Shpallen Masat Emergjente për Furnizimin me Energji, të vlefshme për periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
2. Obligohet Ministria e Ekonomisë që, në bashkëpunim me KEK-un, sipas nevojës të propozojë masa shtesë për të siguruar energji elektrike të mjaftueshme gjatë muajve në vijim.
3. Ndalohet përdorimi i energjisë elektrike për mihjen e kriptovalutave.
4. Me qëllim të mbrojtjes së interesit publik, Qeveria i ofron mbështetje Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për ndërmarrë veprimet e nevojshme në funksion të ruajtjes së sigurisë së sistemit elektro-energetik.
5. Obligohen të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike të marrin masa në kursimin e konsumit të energjisë elektrike.
6. Qeveria e Republikës së Kosovës do të ndërmarrë edhe masa të tjera të veçanta në përputhje me nevojat që mund të paraqiten nga pasojat e krizës energjetike ndërkombëtare.
7. Vendimi hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet menjëherë.

8. Ky Vendim brenda tre (3) ditëve kalendarike nga aprovimi i tij, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/121

Datë: 25.01.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/121
Datë: 25.01.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2023, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore "Kooperativa Bujqësore Podujevë" të cilat janë të nevojshme për realizimin e Projekteve Infrastrukturore në Komunën e Podujevës si më poshtë:
 - Ndërtimi i Lokacionit për "Varrezat e Qytetit" Zona Kadastrale: Obrangjë, Komuna Podujevë;
 - Ndërtimi i "Infrastrukturës Shëndetësore" Zona Kadastrale: Surkish, Komuna Podujevë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit ne pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Subjekti Kërkues - Komuna e Podujevës, do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij vendimi, konform legjislacionit në fuqi.
8. Subjekti Kërkues-Komuna e Podujevës, do të paguajë plotësisht të gjitha obligimet tjera financiare që mund të rrjedhin si pasojë e procesit të shpronësimit dhe vendimet gjyqësore.
9. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë